

VENDIM
Nr. 214, datë 26.5.2021

**PËR MIRATIMIN E FORMËS STANDARDE TË AKTEVE TË VLERËSIMIT TË
NDIHMËSMAGJISTRATIT NË GJYKATËN E LARTË**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 147, pika 1, shkronja “a” të Kushtetutës, nenet 2, 70, pika 3, 74–78, 84–95, 97 dhe 171 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 193, datë 12.5.2021, “Për miratimin e ‘Metodologjia e pikëzimit, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë’” dhe nr. 194, datë 12.5.2021, “Për miratimin e ‘Rregullat e vlerësimit të gjyqtarëve të komanduar në Gjykatën e Lartë’”, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale,

VENDOSI:

1. Miratimin e formës standarde të akteve të vlerësimit të ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë, sipas lidhjeve 1, 2 dhe 3 pjesë e përbërëse e këtij vendimi.

2. Format standarde të akteve të vlerësimit hartohen në format shkresor dhe/ose elektronik, të cilët kanë vlerë të njëjtë.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
KRYETAR
Naureda Llagami

Lidhja I

**FORMULAR I VETËVLERËSIMIT TË NDIHMËSMAGJISTRATIT
NË GJYKATËN E LARTË**

Për periudhën e vlerësimit 20__–20 __

TË DHËNAT E NDIHMËSMAGJISTRATIT

Emri:

Mbiemri:

Datëlindja:

Vendbanimi:

Adresa e *email*-it zyrtar:

Adresa e *email*-it privat:

Numër telefoni:

Gjykata:

Funksioni:

Formulari i vetëvlerësimit (më poshtë “formulari”) dhe hapat për plotësimin e tij

1. Ky formular vetëvlerësimi plotësohet nga ndihmësmagjistrati, në zbatim të nenit 86 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji për statusin).

2. Ky formular është pjesë e akteve të vlerësimit dhe përbën burim vlerësimi në kuptim të nenit 77, shkronjat “ç” dhe “d” të ligjit për statusin.

3. Formularit i bashkëngjiten dy dokumente ligjore të përzgjedhura prej ndihmësmagjistratit për secilin vit vlerësimi, si dhe dokumente që tregojnë angazhimin në veprimtaritë profesionale ndërinstitucionale gjatë periudhës së vlerësimit, trajnimet jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës (përmbajtja, kohëzgjatja, të dhëna mbi institucionin organizues) dhe çdo dokument tjetër që evidenton veprimtarinë profesionale të ndihmësmagjistratit gjatë periudhës së vlerësimit. Dokumentet për trajnimet jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës duhet të evidentojnë përmbajtjen dhe kohëzgjatjen e trajnimit, si dhe të dhëna për institucionin që ka organizuar aktivitetin.

4. Ndhmësmagjistrati plotëson formularin në rubrikat përkatëse të caktuara për të dhe ia dorëzon kryetarit të Gjykatës së Lartë, brenda 3 javëve nga marrja e njoftimit të vendimit të Këshillit për fillimin e procesit të vlerësimit etiko-profesional.

5. Formulari plotësohet në mënyrë elektronike dhe nënshkruhet nga ndihmësmagjistrati.

6. Ndhmësmagjistrati vetëvlerësohet sipas katër grup-kritereve të vlerësimit të parashikuara në ligjin për statusin, duke përzgjedhur vetëm njëren nga shkallët e aftësisë për çdo tregues vlerësimi.

7. Ndhmësmagjistrati bën vetëvlerësimin e aftësive organizative, duke përzgjedhur shkallën e aftësisë për çdo tregues vlerësimi mbi bazën e një analize të pavarur të të dhënave të tij statistikore, referuar tabelave statistikore që i janë vënë në dispozicion para fillimit të procesit të vlerësimit.

8. Ndhmësmagjistrati ka të drejtë të japë shpjegime dhe të argumentojë vetëvlerësimin e tij, duke parashtruar të dhënat, kushtet e punës dhe arsyet që sipas tij/saj justifikojnë një shkallë më të lartë aftësie se ajo që rezulton nga të dhënat statistikore.

VETËVLERËSIMI KUNDREJT KRITEREVE VLERËSUESE

1. Vlerësimi i aftësive profesionale të ndihmësmagjistratit

Me anë të kriterit të aftësisë profesionale të ndihmësmagjistratit vlerësohet aftësia e tij në drejtim të njohuriave ligjore dhe arsyetimit ligjor.

1.A Njohuritë ligjore

1.A-a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për të përcaktuar dhe renditur rrethanat e çështjes, ecurinë procedurale të saj, shkaqet e rekursit/investimit të Gjykatës së Lartë, identifikuar natyrën e mosmarrëveshjes, ligjin e zbatueshëm, konfliktin e normave sipas rastit. Gjithashtu, vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për t'i parashtruar verbalisht çështjet e mësipërme, kur i kërkohet nga gjyqtari relator/kolegji.

Si e vlerëson ndihmësmagjistrati shkallën e aftësisë së tij?

E dobët ☐

Nën mesataren ☐

Mesatare ☐

Mbi mesataren ☐

Shumë e lartë ☐

Shpjegime: (Këtu ndihmësmagjistrati duhet të japë shpjegime referuar veprimtarisë së tij profesionale gjatë periudhës së vlerësimit dhe dokumenteve ligjore të përzgjedhura prej tij.)

1.A-b Aftësia për të interpretuar ligjin në çështjet ligjore materiale ose procedurale, për të cilat i kërkohet përgatitja e analizës ose opinionit ligjor

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për të interpretuar ligjin e identifikuar, analiza për mënyrën e zbatimit të ligjit mbi faktet objekt gjykimi, të cilat vlerësohen në kontekst të çështjes. Në këtë rast vlerësohet aftësia për t'u bazuar te parimet e përgjithshme të së drejtës materiale e procedurale, që kanë lidhje me interpretimin e ligjit në zgjidhjen e çështjes, për të kërkuar, njohur dhe analizuar jurisprudencën vendëse dhe ndërkombëtare/GJEDNJ, duke u përqendruar te një çështje të caktuar, sa dhe si ndihmësmagjistrati identifikon praktikën gjyqësore vendëse dhe atë ndërkombëtare, në mbështetje të një vendimi ose interpretimi të caktuar, si përdor dhe krabason burime jurisprudenciale nga sistemi ligjor vendës dhe nga sisteme të tjera.

Si e vlerëson ndihmësmagjistrati shkallën e aftësisë së tij?

E dobët ☐

Nën mesataren ☐

Mesatare ☐

Mbi mesataren ☐

Shumë e lartë ☐

Shpjegime: (Këtu ndihmësmagjistrati duhet të japë shpjegime referuar veprimtarisë së tij profesionale gjatë periudhës së vlerësimit dhe dokumenteve ligjore të përzgjedhura prej tij.)

1.B Arsyetimi ligjor

1.B-a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e dokumentit ligjor

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për të qenë i qartë, konciz, elokuent dhe lehtësisht i kuptueshëm në dokumentet ligjore të hartuara prej tij, si dhe në prezantimet verbale para kolegjit, kur i kërkohet, aftësia për të përmbledhur shkaqet e rekursit, procedurës së zbatueshme, arsyetimit të gjykatave më të ulëta dhe çështjeve të tjera ligjore. Vlerësohet aftësia për të përdorur thjesht dhe drejtpërdrejt gjuhën shqipe, aftësia për të shprehur mendimin qartë dhe në mënyrë të përmbledhur, zbatimin e saktë të rregullave gramatikore dhe të atyre të sintaksës, përzgjedhja e kujdesshme e gjuhës dhe përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip (ë dhe ç), organizimi i paragrafëve dhe i strukturës së fjalisë për të shprehur kuptimin, përdorimi në mënyrë korrekte dhe konsistente të termave teknikë.

Si e vlerëson ndihmësmagjistrati shkallën e aftësisë së tij?

E dobët ☐

Nën mesataren ☐

Mesatare ☐

Mbi mesataren ☐

Shume e lartë ☐

Shpjegime: (Këtu ndihmësmagjistrati duhet të japë shpjegime referuar veprimtarisë së tij profesionale gjatë periudhës së vlerësimit dhe dokumenteve ligjore të përzgjedhura prej tij.)

1.B-b Struktura e qëndrueshme dhe e mirorganizuar e dokumentit ligjor

Në këtë tregues vlerësohet nëse dokumentet ligjore të dorëzuara nga ndihmësmagjistrati dhe ato të përzgjedhura me short përmbajnë një strukturë të qartë, të qëndrueshme, të mirorganizuar, e cila respektohet me përpikëri gjatë prezantimit të fakteve, në identifikimin e ligjit të zbatueshëm dhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura.

Si e vlerëson ndihmësmagjistrati shkallën e aftësisë së tij?

E dobët ☐

Nën mesataren ☐

Mesatare ☐

Mbi mesataren ☐

Shumë e lartë ☐

Shpjegime: (Këtu ndihmësmagjistrati duhet të japë shpjegime referuar veprimtarisë së tij profesionale gjatë periudhës së vlerësimit dhe dokumenteve ligjore të përzgjedhura prej tij.)

1.B-c Cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për të identifikuar marrëdhëniet shkak-pasojë, si edhe për të analizuar se si konceptet, institutet e së drejtës dhe dispozitat lidhen midis tyre, ose se si ato zbatohen në një situatë të caktuar. Në veçanti, në dokumentet ligjore të dorëzuara prej tij dhe ato të përzgjedhura me short, vlerësohet nëse përmbajtja është gjithëpërfshirëse, duke u dhënë përgjigje të gjitha çështjeve ligjore që ngrihen për diskutim, si dhe nëse nga ana e ndihmësmagjistratit evidentohet nevoja për të njëjshuar apo ndryshuar praktikën gjyqësore.

Si e vlerëson ndihmësmagjistrati shkallën e aftësisë së tij?

E dobët ☐

Nën mesataren ☐

Mesatare ☐

Mbi mesataren ☐

Shumë e lartë ☐

Shpjegime: (Këtu ndihmësmagjistrati duhet të japë shpjegime referuar veprimtarisë së tij profesionale gjatë periudhës së vlerësimit dhe dokumenteve ligjore të përzgjedhura prej tij.)

2. Vlerësimi i aftësive organizative të ndihmësmagjistratit

Me anë të kriterit të aftësive organizative vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për të përballuar ngarkesën në punë, menaxhimin efektiv të kohës, si në planifikimin e çështjeve që ai përgatit në funksion të shqyrtimit të çështjeve gjyqësore nga gjykata në dhomë këshillimi

ose seancë gjyqësore, ashtu edhe në veprimet procedurale jashtë tyre, pa krijuar pengesa në ecurinë e gjykimit të çështjeve në kolegje. Ky komponent vlerësohet sipas tri aspekteve: sasisë, shpejtësisë dhe metodologjisë.

2.A Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

2.A-a Treguesi sasior në përfundimin e dokumenteve ligjore për çështjet gjyqësore

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për të përballuar ngarkesën në punë, sipas standardit minimal të caktuar, për çdo kategori çështjesh, e cila matet ndërmjet krabasimit të numrit total të çështjeve të përgatitura për shqyrtim (të përfunduara + të papërfunduara), me standardin sasior të përcaktuar.

Ndihmësmagjistrati bën një analizë të pavarur të të dhënave të tij statistikore dhe përzgjedh sbkallën e aftësisë së tij.

Nën standard ☐	Në standard ☐	Mbi standard ☐
Shpjegime: (Këtu ndihmësmagjistrati mund të japë shpjegime mbi situatën faktike lidhur me kompleksitetin e çështjeve, volumin e tyre, rritjen e papritur të volumit të çështjeve dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të justifikojnë një pikëzim më të lartë referuar “Metodologjisë së pikëzimit, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë”, miratuar me vendimin e KLGJ-së nr. 193, datë 12.5.2021, deri në pikëzim maksimal.)		

2.A-b Rendimenti i përfundimit të dokumenteve ligjore për çështjet gjyqësore

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për përfundimin e dokumenteve ligjore, duke iu referuar raportit të numrit të çështjeve të përgatitura për shqyrtim (të përfunduara + të papërfunduara) pavarësisht kohës së caktimit të tyre, me numrin e çështjeve tëaktuara për relativitet brenda një viti kalendarik.

Ndihmësmagjistrati bën një analizë të pavarur të të dhënave të tij statistikore dhe përzgjedh sbkallën e aftësisë së tij.

Nën 81 % ☐	Mbi 81–87 % ☐	Mbi 87–93 % ☐	Mbi 93–99 % ☐	+99% ☐
Shpjegime: (Këtu ndihmësmagjistrati mund të japë shpjegime mbi situatën faktike lidhur me kompleksitetin e çështjeve, volumin e tyre, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, si dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të justifikojnë një pikëzim më të lartë, referuar “Metodologjisë së pikëzimit, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë”, miratuar me vendimin e KLGJ-së nr. 193, datë 12.5.2021, deri në pikëzimin maksimal, nëse ndihmësmagjistrati ka përfunduar brenda të njëjtit viti kalendarik më shumë se 50% të standardit minimal sasior të përcaktuar nga mbledhja e gjyqtarëve dhe/ose kryetari.)				

B. Aftësia për të përfunduar në kohë çështjet e ngarkuara

2.B-a Respektimi i standardeve minimale kohore

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për të respektuar afatet orientuese të miratuara për çdo kategori çështjesh, referuar raportit të çështjeve për të cilat dokumentet ligjore janë përgatitur tej standardit minimal kohor, me numrin total të çështjeve të përgatitura (të përfunduara + të papërfunduara).

Ndihmësmagjistrati bën një analizë të pavarur të të dhënave të tij statistikore dhe përzgjedh sbkallën e aftësisë së tij.

1–10 % ☐	11–20 % ☐	21–30 % ☐	31–40 % ☐	Mbi 40 % ☐
Shpjegime: (Këtu ndihmësmagjistrati mund të japë shpjegime mbi situatën faktike lidhur me kompleksitetin e çështjeve, volumin e tyre, rritjen e papritur të volumit të çështjeve dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të justifikojnë një pikëzim më të lartë referuar “Metodologjisë së pikëzimit, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë”, miratuar me vendimin e KLGJ-së nr. 193, datë 12.5.2021 deri në pikëzim maksimal.)				

2.B-b Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje të përgatitur për relativ

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për të përpunuar dokumentet ligjore për çdo çështje në afat, sipas kategorisë përkatëse, në raport me standardet minimale kohore të miratuara, për çdo kategori.

Ndihmësmagjistrati bën analizën e pavarur të të dhënave të tij statistikore dhe përzgjedh shkallën e aftësisë së tij. Ai përzgjedh një nga nivelet e mëposhtme pas krabasimit me standardet e miratuara.

Më e gjatë se standardi për të gjitha kategoritë e çështjeve ☐	Më e gjatë se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve ☐	Më e gjatë se standardi për gjysmën e kategorive të çështjeve ☐	Më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve ☐	Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve ☐
---	---	--	--	---

Shpjegime: (Këtu ndihmësmagjistrati mund të japë shpjegime mbi situatën faktike lidhur me kompleksitetin e çështjeve, volumin e tyre, rritjen e papritur të volumit të çështjeve dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të justifikojnë një pikëzëm më të lartë referuar “Metodologjisë së pikëzimit, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë”, miratuar me vendimin e KLGJ-së nr. 193, datë 12.5.2021 deri në pikëzëm maksimal.)

C. Metodologjia e punës (aftësia për të qenë efektiv në menaxhimin e kohës)

2.C-a Aftësia për të evidentuar e kryer veprimet e nevojshme dhe shmangien e veprimeve joproduktive në funksion të organizimit të procesit gjyqësor

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit në drejtim të dhënies së ndihmës dhe kontributit aktiv për kryerjen me eficiencë të veprimeve, të tilla si: respektimin e rendit kronologjik të çështjeve për t'u përgatitur në përputhje me afatet ligjore; respektimin e afateve të përcaktuara nga gjyqtari relator/kolegji në kryerjen e veprimeve përgatitore efektive dhe në kohë në bashkëpunim me kryesekretarinë e gjykatës; planifikimin dhe zhvillimin e seancave me apo pa pjesëmarrjen e palëve (njoftimin, shpalljen etj.); dokumentimin e vendimeve dhe veprimeve të tjera procedurale; ndjekjen me rigorozitet të seancave apo diskutimeve për çështjen; ndihmën në përgatitjen e vendimit në formën që u njoftohet palëve nëse kërkohet nga gjyqtari relator.

Si e vlerëson ndihmësmagjistrati shkallën e aftësisë së tij?

E dobët ☐	Nën mesataren ☐	Mesatare ☐	Mbi mesataren ☐	Shumë e lartë ☐
----------------------------------	--	-----------------------------------	--	--

Shpjegime:

2.C-b Aftësia për të evidentuar brenda çështjeve të caktuara për relativ, ato që kërkojnë vëmendje të posaçme dhe që duhet të trajtohen me përparësi, për shkak të kërkesave procedurale.

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për të evidentuar shpejt dhe pa humbur kohë çështje që kërkojnë vëmendje të posaçme, si p.sh.: kërkesat për përshpejtim, pezullim, rastet kur kërkohet apo është e nevojshme përjashtimi i gjyqtarit relator apo raste të tjera të ngjashme, me qëllim evitimin e vonesave në shqyrtimin e çështjeve.

Si e vlerëson ndihmësmagjistrati shkallën e aftësisë së tij?

E dobët ☐	Nën mesataren ☐	Mesatare ☐	Mbi mesataren ☐	Shumë e lartë ☐
----------------------------------	--	-----------------------------------	--	--

Shpjegime:

2.C-c Rregullshmëria, saktësia e plotësia e dosjes gjyqësore

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për ruajtjen e renditjes së akteve të dosjes dhe të materialeve të tjera dokumentare, në mënyrë të tillë që dosja të jetë lehtësisht e shfrytëzueshme, si dhe aftësia e tij për të garantuar rregullshmërinë, plotësinë dhe saktësinë e dokumenteve pjesë e dosjes gjyqësore, që krijohet në Gjykatën e Lartë, nga momenti i marrjes së saj deri në dorëzimin në sekretari pas përfundimit të çështjes.

Si e vlerëson ndihmësmagjistrati shkallën e aftësisë së tij?

E dobët ☐

Nën mesataren ☐

Mesatare ☐

Mbi mesataren ☐

Shumë e lartë ☐

Shpjegime:

3. Vlerësimi i etikës dhe i angazhimit ndaj vlerave profesionale

Pikëzimi i këtij treguesi vlerësimi bëhet mbi bazën e parimit kushtetues që çdo ndihmësmagjistrat, për shkak të statusit të tij ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Procesi i vlerësimit për këtë kriter bazohet në parimin e prezumimit të pasjes së vlerave të tilla themelore, në lidhje me ushtrimin e detyrës.

3.A Etika në punë

3.A-a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për të shfaqur sjellje të kujdesshme, objektive, me vetëpërmbytje dhe maturi gjatë ushtrimit të detyrës, në mënyrë korrekte, të ndërgjegjshme, sistematike dhe në kohë të arsyeshme, duke shmangur në mënyrë të ndërgjegjshme dhe me vërtetësi çdo sjellje që tregon mungesë respekti, vetëpërmbytje, ndjeshmërie, vëmendjeje apo qasje të papërshtatshme dhe ofensive, duke mos u kufizuar vetën me shmangien e sjelljeve që formalisht përcaktohen si në kundërshtim me ligjin.

Si e vlerëson ndihmësmagjistrati shkallën e tij të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion?

E dobët ☐

Nën mesatare ☐

Mesatare ☐

Mbi mesataren ☐

Shumë e lartë ☐

Shpjegime:

3.B Integriteti

3.B-a Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për të respektuar, miratuar dhe mbështetur vlerat themelore të punës së tij, siç janë shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti; aftësia për t'iu përgjigjur pritshmërive të publikut, duke demonstruar cilësitë personale të mençurisë, ndershmërisë, ndjenjës së humanizmit, guximit, seriozitetit dhe maturisë, duke vepruar me vetëdije se sjellja profesionale, jeta private dhe sjellja e tij në shoqëri kanë ndikim në imazhin e drejtësisë dhe të besimit të publikut. Shmangia e shfaqjes së pahijshme është themelore për integritetin. Gjatë punës së tyre si ndihmësmagjistratë ata duhet të përpiqen të shmangin të gjitha paragjykimet që mund të dëmtojnë ose të konsiderohen si të dëmshme gjatë bartimit të dokumenteve ligjore për çështjet në gjykim. Ndihmësmagjistratët, megjithëse nuk kryejnë funksione vendimmarrëse por ndihmëse, nuk duhet të mbajnë qëndrime favorizuese ose disfavorizuese, në lidhje me çështjet për të cilat japin kontributin e tyre ndihmës për gjyqtarët në Gjykatën e Lartë.

*Si e vlerëson ndihmësmagjistrati aftësinë e tij për shmangien e sjelljeve të pahijshme, nderin dhe dinjitetin e tij?
(Prezumat se ndihmësmagjistrati ka shkallë shumë të lartë integriteti.)*

E dobët ☐

Shumë e lartë ☐

Shpjegime:

3.C Paanësia

3.C-a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese

Me këtë tregues vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese, si dhe çdo tendencë për paragjykim.

Si e vlerëson ndihmësmagjistrati aftësinë e tij për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese?

E dobët ☐

Nën mesataren ☐

Mesatare ☐

Mbi mesataren ☐

Shume e lartë ☐

Shpjegime:

3.C-b Numri tejet i lartë i kërkesave për heqje dorë të refuzuara nga kryetari

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për të shfaqur paanësi në funksion, referuar raportit të numrit të çështjeve të caktuara ndihmësmagjistratit gjatë periudhës së vlerësimit dhe numrit të kërkesave të bëra prej tij për heqje dorë, të refuzuara nga kryetari.

Si e vlerëson ndihmësmagjistrati numrin e kërkesave për heqje dorë të refuzuara nga kryetari?

Tejet i lartë ☐

I pakonsiderueshëm ☐

Shpjegime:

4. Vlerësimi i aftësive personale dhe angazhimit profesional

Me anë të këtij kriteri vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i ndihmësmagjistratit, duke vlerësuar aftësitë komunikuese, aftësinë për të bashkëpunuar

me kolegët dhe administratën e gjykatës, gatishmëria e tij për t'u angazhuar në veprimtari të tjera.

4.A Aftësia e komunikimit

4.A-a Komunikimi i qartë dhe transparent

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për të qenë transparent në komunikim dhe për t'u shprehur në mënyrë të kuptueshme, të qartë dhe koncize me gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, publikun (nëse është rasti), subjektet e tjera dhe të tretët.

Si e vlerëson ndihmësmagjistrati aftësinë e tij për të komunikuar qartë dhe në mënyrë transparente?

E dobët ☐

Nën mesataren ☐

Mesatare ☐

Mbi mesataren ☐

Shumë e lartë ☐

Shpjegime:

4.A-b Respektimi i konfidencialitetit dhe i mbrojtjes së të dhënave personale

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për të treguar kujdes për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, në lidhje me informacionit dhe të dhënat për të cilat ai vibet në dijeni për shkak të funksionit.

Si e vlerëson ndihmësmagjistrati aftësinë e tij, në lidhje me respektimin e konfidencialitetit dhe të dhënave personale?

I dobët ☐

Mesatar ☐

I lartë ☐

Shpjegime:

4.B Aftësia për të bashkëpunuar

4.B-a Gatishmëria dhe shkalla e komunikimit dhe e bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta.

Në këtë tregues vlerësohet aftësia dhe disponibiliteti i ndihmësmagjistratit për të bashkëpunuar me kolegët, pa cenuar pavarësinë e tij, aftësia për të kontribuar në ngritjen e problemeve, diskutimin dhe propozimet mbi çështje të caktuara juridike, përmirësimet e legjislacionit, diskutimin rreth zbatimit apo ndryshimit të vendimeve njësuere, hartimin e modeleve të unifikuara të akteve procedurale, dhe çdo çështje tjetër që lidhet me veprimtarinë gjyqësore. Vlerësohet gatishmëria e ndihmësmagjistratit për të ndarë me kolegët përvojën e përfutur në aktivitetet e ndryshme trajnuese.

Si e vlerëson ndihmësmagjistrati aftësinë e tij, në lidhje me shkallën e komunikimit dhe të bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta?

E dobët ☐

Nën mesataren ☐

Mesatare ☐

Mbi mesataren ☐

Shumë e lartë ☐

Shpjegime:

4.B-b Gatishmëria dhe kontributi për të kryer edhe detyra të tjera që i ngarkohen nga organet drejtuese të Gjykatës

Në këtë tregues vlerësohet gatishmëria e ndihmësmagjistratit për të dhënë kontributin e tij edhe në çështje të tjera që lidhen me veprimtarinë e Gjykatës së Lartë, si p.sh. propozime për ndryshime ligjore, përmirësimin e akteve të brendshme rregulluese të gjykatës, organizimin me eficient të administratës gjyqësore etj.

Si e vlerëson ndihmësmagjistrati aftësinë e tij për të kryer detyra të tjera që i ngarkohen?

Shpjegime: (Ndihmësmagjistrati duhet listojë të dhënat mbi kontributin e dhënë dhe produktet konkrete të përgatitura në kuadër të kësaj veprimtarie.)

4.B-c Aftësia për të bashkëpunuar dhe për të reaguar me efikasitet në rast nevojë

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për të qenë bashkëpunues, për të reaguar me efikasitet në rast të shfaqjes së problemeve apo vështirësive në punë, duke ruajtur qetësinë, etikën dhe synuar zgjidhjen e menjëhershme dhe me efektivitet të konflikteve. Vlerësohet veçanërisht marrëdhënia korrekte me gjyqtarët, kancelarin dhe administratën gjyqësore.

Si e vlerëson ndihmësmagjistrati aftësinë e tij për të bashkëpunuar dhe reaguar me efikasitet në rast nevojë?

E dobët ☐

Nën mesataren ☐

Mesatare ☐

Mbi mesataren ☐

Shumë e lartë ☐

Shpjegime:

4.C Gatishmëria për t'u angazhuar në veprimtari të tjera

4.C-a Pjesëmarrja në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale

Në këtë tregues vlerësohet angazhimi i ndihmësmagjistratit në programin e trajnimit vazhdues pranë Shkollës së Magjistraturës, si dhe në aktivitete të tjera trajnuese jashtë këtij programi, me qëllim ngritjen e tij profesionale.

A e ka përmbushur ndihmësmagjistrati detyrimin ligjor mbi pjesëmarrjen në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale, gjatë periudhës së vlerësimit?

Po ☐

Jo ☐

Shpjegime: (Këtu ndihmësmagjistrati duhet të përcaktojë pjesëmarrjen në aktivitete trajnuese të zhvilluara jashtë programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, duke specifikuar përmbajtjen dhe kohëzgjatjen e trajnimit, si dhe të dhëna për institucionin që ka organizuar aktivitetin. Dokumentacionin përkatës ia bashkëlidh formularit.)

4.C-b Disponueshmëria e ndihmësmagjistratit për trajnimin e gjyqtarëve.

Në këtë tregues vlerësohet gatishmëria e ndihmësmagjistratit për të kontribuar si ekspert/lehtësues në trajnimin fillestar apo vazhdues të Shkollës së Magjistraturës apo në trajnime të organizuara nga institucione të tjera.

Shpjegime: (Ndihmësmagjistrati duhet të listojë këtu informacione mbi pjesëmarrjen dhe/ose përfshirjen në veprimtari të trajnuese në të cilat është angazhuar.)

4.C-c Pjesëmarrja në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë

Në këtë tregues vlerësohet aftësia dhe gatishmëria e ndihmësmagjistratit për t'u angazhuar në veprimtari për të përmirësuar sistemin e drejtësisë, me ose pa pagesë, të tilla si: prezantime në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare; pjesëmarrje në programet e edukimit të komunitetit; bashkëpunimi me Këshillin për përmirësimin e programeve të formimit vazhdues; angazhimi si ekspert në punët e Këshillit për përgatitjen e formave standarde me qëllim rritjen e eficiencës; kontribute në hartimin e legjislacionit; aktivitete mësimdhënëse për çështje ligjore; bashkëpunimi me grupe interesash të ndryshëm, me qëllim rritjen e cilësisë së gjyqësorit dhe ndërgjegjësimin e publikut për forcën e zbatimit të ligjit, si edhe çdo veprimtari tjetër e ngjashme në fushën juridike.

Shpjegime: (Ndihmësmagjistrati duhet të listojë këtu informacione mbi pjesëmarrjen dhe/ose përfshirjen në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë, si dhe kontributin e tij në këto veprimtari.)

4.C-ç Publikime ligjore akademike

Në këtë tregues vlerësohet aftësia dhe gatishmëria e ndihmësmagjistratit për të publikuar shkrime, artikuj ligjorë me natyrë akademike ose praktike me qëllim dhënien e kontributit për zhvillimin e doktrinës apo njohjen e praktikantëve të së drejtës me zhvillimet më të fundit të jurisprudencës vendëse dhe të buaj.

Shpjegime: (Ndihmësmagjistrati duhet të listojë këtu informacione mbi botimet e tij si p.sh. të dhënat për sasinë, tipologjinë dhe impaktin e publikimeve ligjore akademike. Dokumentacionin përkatës ia bashkëlidh formularit.)

Në referim të nenit 86, pika 1, shkronjat “c”, “ç”, “d”, “dh” të “Ligjit për statusin”, ndihmësmagjistrati jep mendim për sa më poshtë:

a) Masat e ndërmarra për përmbushjen e objektivave të përcaktuar në vlerësimin e mëparshëm dhe shkalla e përmbushjes së tyre.

Shpjegime:

b) Objektivat për zhvillimin e tij profesional për vlerësimin e ardhshëm.

Shpjegime:

c) Nevojat për trajnim dhe rrethanat të cilat përbëjnë pengesë për zhvillimin e tij profesional, duke propozuar zgjidhje konkrete për periudhën e ardhshme të vlerësimit.

Shpjegime:

Në referim të nenit 86, pika 2, të “Ligjit për statusin” ndihmësmagjistrati i bashkëlidh formularit të vetëvlerësimit dy dokumente ligjore të përzgjedhura prej tij, për çdo vit të periudhës së vlerësimit.

a) Dokumentet ligjore të përzgjedhura nga ndihmësmagjistrati

Dokumentet ligjore të përzgjedhura listohen në këtë rubrikë dhe i bashkëlidhen formularit të vetëvlerësimit.

Për t'u plotësuar nga ndihmësmagjistrati:

Plotësuar nga

Emër:

Mbiemër:

Nënshkrimi:

Dorëzuar në datën

Marrë në dorëzim nga kryetari

Emër:

Mbiemër:

Nënshkrimi:

Lidhja II

**FORMULAR I MENDIMIT TË KOLEGJIT
PËR VLERËSIMIN E NDIHMËSMAGJISTRATIT
NË GJYKATËN E LARTË**

Për periudhën e vlerësimit 20__–20 __

TË DHËNAT E NDIHMËSMAGJISTRATIT

Emri:

Mbiemri:

Datëlindja:

Vendbanimi:

Adresa e *email*-it zyrtar:

Adresa e *email*-it privat:

Numër telefoni:

Gjykata:

Funksioni:

Formulari i mendimit të kolegjit (më poshtë “formulari”) dhe hapat për plotësimin e tij:

1. Ky formular përmban mendimin dhe vlerësimin që kolegji i bën veprimtarisë së ndihmësmagjistratit gjatë periudhës së vlerësimit.

2. Ky formular është pjesë e akteve të vlerësimit dhe përbën burim vlerësimi në kuptim të nenit 77, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e

Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji për statusin), si dhe vendimit të KLGJ nr. 194, datë 12.5.2021, “Rregullat e vlerësimit të gjyqtarëve të komanduar në Gjykatën e Lartë”.

3. Formulari plotësohet nga kolegji pranë të cilit ndihmësmagjistrati ka ushtruar funksionin. Në rast se ndihmësmagjistrati, gjatë periudhës së vlerësimit, ka ushtruar funksionin në më shumë se një kolegji të Gjykatës së Lartë, formulari plotësohet nga secili kolegji më vete.

4. Kolegji, brenda 3 javëve nga marrja e njoftimit të vendimit të Këshillit për fillimin e procesit të vlerësimit etik dhe profesional, plotëson formularin, në rubrikat përkatëse dhe ia dërgon kryetarit të Gjykatës së Lartë.

5. Formulari plotësohet në mënyrë elektronike dhe nënshkruhet nga anëtarët e kolegjit.

Vlerësimi i kolegjit bazohet në standardet e mëposhtme:

6. Në mendimin e kolegjit përshkruhet dhe vlerësohet veprimtaria e ndihmësmagjistratit sipas katër grup-kritereve të vlerësimit të parashikuara në ligjin për statusin, konkretisht për:

- aftësitë profesionale;
- aftësitë organizative;
- etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale;
- aftësitë personale dhe angazhimin profesional.

7. Për kriterin e “Aftësive profesionale” kolegji jep mendim dhe vlerëson ndihmësmagjistratin, për:

i. Njohuritë ligjore, duke dhënë mendim për:

a) aftësinë për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave;

b) aftësinë për të interpretuar ligjin në çështjet ligjore dhe materiale ose procedurale, për të cilat i kërkohet përgatitja e dokumentit ligjor.

ii. Arsyetimi ligjor, duke dhënë mendim, për:

a) qartësinë, koncizitetin dhe kuptueshmërinë e dokumentit ligjor;

b) strukturën e qëndrueshme dhe të mirorganizuar të dokumentit ligjor;

c) cilësinë e analizës dhe argumentimin logjik.

8. Për kriterin e “aftësive organizative”, kolegji vlerëson ndihmësmagjistratin, për:

i. Aftësinë për të përballuar ngarkesën në punë (treguesi sasior), nëpërmjet:

a) treguesit sasiorë në përfundimin e dokumenteve ligjore për çështjet gjyqësore;

b) rendimentit të përfundimit të dokumenteve ligjore për çështjet gjyqësore;

ii. Aftësinë për të përfunduar në kohë çështjet e ngarkuara (treguesi i shpejtësisë), në drejtim të:

a) respektimit të standardit minimal kohor;

iii. Metodologjisë së punës (aftësia për të qenë efektiv në menaxhimin e kohës), në drejtim të:

a) aftësisë për të evidentuar dhe kryer veprimet e nevojshme dhe shmangien e veprimeve joproduktive në funksion të organizimit të procesit gjyqësor;

b) aftësisë për të evidentuar brenda çështjeve të caktuara për relativitet, ato që kërkojnë vëmendje të posaçme dhe që duhet të trajtohen me përparësi për shkak të kërkesave procedurale;

c) rregullshmërisë, saktësisë e plotësisë së dosjes gjyqësore.

9. Për kriterin e “etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale”, kolegji jep mendim dhe vlerëson ndihmësmagjistratin, për:

i. Etikën në punë, e vlerësuar nëpërmjet angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion;

ii. Integritetin e ndihmësmagjistratit, i vlerësuar nëpërmjet shmangies së shfaqjes së pahijshme dhe transmetimit të vlerave personale dhe profesionale si nderi dhe dinjiteti;

iii. Paanësinë në funksion, e vlerësuar nëpërmjet përdorimit ose jo të gjuhës diskriminuese.

10. Për kriterin “aftësitë personale dhe angazhimi profesional”, kolegji jep mendim dhe vlerëson ndihmësmagjistratin, për:

i. Aftësitë e komunikimit, nëpërmjet:

a) komunikimit të qartë dhe transparent;

b) respektimit të konfidencialitetit dhe të mbrojtjes së të dhënave personale.

11. Vlerësimi për etikën, integritetin dhe paanësinë jepet bazuar mbi prezumimin se ndihmësmagjistrati i ka këto cilësi. Kolegji parashtron dhe jep mendim për problematika të shfaqura nga ndihmësmagjistrati, të tilla që duhet të merren parasysh në vlerësim.

12. Vlerësimi i kolegjit bazohet në të dhëna objektivist të konstatuara gjatë gjithë veprimtarisë së ndihmësmagjistratit, pavarësisht të dhënave që përmbajnë burimet e tjera të vlerësimit.

13. Mendimi i kolegjit jepet duke u bazuar në nivelet e vlerësimit të parashikuara në nenin 78 të ligjit për statusin, duke përzgjedhur vetëm njërin nga shkallët e aftësisë për çdo tregues vlerësimi. Kolegji jep shpjegime dhe argumenton mendimin e tij.

14. Nëse kryetari i Gjykatës është njëkohësisht edhe anëtar i kolegjit, ai jep mendimin e tij në këtë formular vetëm për kriterin e aftësive profesionale. Mendimi i kryetarit për tri kriteret e tjera jepet në formularin e mendimit të kryetarit.

VLERËSIMI KUNDREJT KRITEREVE VLERËSUESE

1. Vlerësimi i aftësive profesionale të ndihmësmagjistratit.

Me anë të kriterit të aftësisë profesionale të ndihmësmagjistratit vlerësohet aftësia e tij në drejtim të njohurive ligjore dhe arsyetimit ligjor.

1.A Njohuritë ligjore

1.A-a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për të përcaktuar dhe renditur rrethanat e çështjes, ecurinë procedurale të saj, shkaqet e rekursit/investimit të Gjykatës së Lartë, identifikuar natyrën e mosmarrëveshjes, ligjin e zbatueshëm, konfliktin e normave sipas rastit. Gjithashtu, vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për të parashtruar verbalisht çështjet e mësipërme, kur i kërkohet nga gjyqtari relator/kolegji.

Si e vlerëson kolegji shkallën e aftësisë së ndihmësmagjistratit?

E dobët ☐

Nën mesataren ☐

Mesatare ☐

Mbi mesataren ☐

Shumë e lartë ☐

Shpjegime: (Këtu kolegji argumenton vlerësimin e tij referuar veprimtarisë profesionale të ndihmësmagjistratit gjatë periudhës së vlerësimit.)

1.A-b Aftësia për të interpretuar ligjin në çështjet ligjore materiale ose procedurale, për të cilat i kërkohet përgatitja e analizës ose opinionit ligjor

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për të interpretuar ligjin e identifikuar, analiza për mënyrën e zbatimit të ligjit mbi faktet objekt gjykimi, të cilat vlerësohen në kontekst të çështjes. Në këtë rast vlerësohet aftësia për t'u bazuar te parimet e përgjithshme të së drejtës materiale e procedurale që kanë lidhje me interpretimin e ligjit në zgjidhjen e çështjes, për të kërkuar, njohur dhe analizuar jurisprudencën vendëse dhe ndërkombëtare/GJEDNJ, duke u përqendruar te një çështje e caktuar, sa dhe si ndihmësmagjistrati identifikon praktikën gjyqësore vendëse dhe atë ndërkombëtare, në mbështetje të një interpretimi të caktuar, si përdor dhe krabason burime jurisprudenciale nga sistemi ligjor vendës dhe nga sisteme të tjera.

Si e vlerëson kolegji shkallën e aftësisë së ndihmësmagjistratit?

E dobët ☐

Nën mesataren ☐

Mesatare ☐

Mbi mesataren ☐

Shumë e lartë ☐

Shpjegime: (Këtu kolegjii argumenton vlerësimin e tij referuar veprimtarisë profesionale të ndihmësmagjistratit gjatë periudhës së vlerësimit.)

1.B Arsytimi ligjor

1.B-a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e dokumentit ligjor

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për të qenë i qartë, konciz, elokuent dhe lehtësisht i kuptueshëm në dokumentet ligjore të hartuara prej tij, si dhe në prezantimet verbale para kolegjit, kur i kërkohet, aftësia për të përmbledhur shkaqet e rekursit, procedurës së zbatueshme, arsytimit të gjykatave më të ulëta dhe çështjeve të tjera ligjore. Vlerësohet aftësia për të përdorur thjesht dhe drejtpërdrejt gjuhën shqipe, aftësia për të shprehur mendimin qartë dhe në mënyrë të përmbledhur, zbatimin i saktë i rregullave gramatikore dhe i atyre të sintaksës, përzgjedhja e kujdesshme e gjuhës dhe përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip (ë dhe ç), organizimi i paragrafëve dhe i strukturës së fjalisë për të shprehur kuptimin, përdorimi në mënyrë korrekte dhe konsistente i termave teknikë.

Si e vlerëson kolegjii shkallën e aftësisë së ndihmësmagjistratit?

E dobët ☐

Nën mesataren ☐

Mesatare ☐

Mbi mesataren ☐

Shume e lartë ☐

Shpjegime: (Këtu kolegjii argumenton vlerësimin e tij referuar veprimtarisë profesionale të ndihmësmagjistratit gjatë periudhës së vlerësimit.)

1.B-b Struktura e qëndrueshme dhe e mirorganizuar e dokumentit ligjor

Në këtë tregues vlerësohet nëse ndihmësmagjistrati ndjek një strukturë të qartë, të qëndrueshme, të mirorganizuar në përpilimin e dokumentit ligjor, e cila respektohet me përpikëri gjatë prezantimit të fakteve, në identifikimin e ligjit të zbatueshëm dhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura.

Si e vlerëson kolegjii shkallën e aftësisë së ndihmësmagjistratit?

E dobët ☐

